



Pranuar / Received Prilbuar / Prilbuar Received / Received	22.04.2021	1	viti god year
Organ / Organ Organ / Organ	No. Prot. In Prot. Prot. No.	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKAMSHUK	1952/2021		1/3.



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.251/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë dhe Avdyl Bektashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.251/2021 të datës 06.04.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi në fshatin Brod, Komuna e Dragashit, kundër organit të punësimit/Komuna e Dragashit, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 21.04.2021, mori këtë:

### V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.251/2021 e datës 06.04.2021 e parashtruar nga ankuesi

### A r s y e t i m

Ankuesi më datë 06.04.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 1610/2021 të regjistruar me numër A.nr.251/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për kthimin e tij në pozitën e punës Bashkëpunëtor i Lartë Profesional dhe Inspektor i Tatimeve në Komunën e Dragashit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 14.04.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Komuna e Dragashit. Këshilli, me datë 15.04.2021 ka pranuar përgjigje në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:* Ankesën me numër protokolli 1610/2021 të regjistruar me numër A.nr.251/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën e datës 12.06.2020 të parashtruar nga ankuesi për Kryetarin e Komunës së Dragashit; Vendim me Nr.070/2017 të datës 29.09.2017; Vendimin me Nr.86/2015 të datës 13.08.2015; Vendimin me Nr.020 të datës 23.05.2011; Vendimin e datës 23.03.2008 të Kryetarit të Kuvendit të Kosovës; Kontratën e punës të datës 01.04.2003 dhe 08.07.2000 të ankuesit; Aktvendimin e datës 15.12.1999; Formularin për kërkesë apo ankesë të datës 12.06.2020 nga ankuesi; Vendimin e datës 27.01.2003 për emërimin e ankuesit Drejtor i Drejtoratit për Ekonomi, Financa, Tregti dhe Biznes në Komunën e Dragashit; Qarkullimi për llogari bankare të datë 22.12.2020; Kontratën mbi vazhdimin e punës të datë 25.06.2007, 04.01.2007, 01.04.2005, 01.04.2004; dhe Përgjigjen në ankesë të datës 15.04.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuat të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është palejuar, sepse:*

Bazuat në shkresat e lëndës është konstatuar se ankuesi me datë 15.12.1999 është pranuar në marrëdhënie punës në pozitën "Inspektor i Tatimeve" në Komunën e Dragashit, ndërsa nga data 27.01.2003 i njëjti është emëruar Drejtor i Drejtoratit për Ekonomi, Financa, Tregti dhe Biznes në Komunën e Dragashit. Me Vendimin e datës 15.02.2008 të Kryetarit të Kuvendit të Kosovës, ankuesi është emëruar zëvendësministër në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Po ashtu me Vendimin Nr.020 të datës 23.05.2011 dhe Vendimin Nr.86/2015 të datës 13.08.2015 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, i njëjti është emëruar zëvendësministër i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Ndërsa në vitin 2017, përmes Vendimit Nr.070/2017 të datës 29.09.2017 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, ankuesi është emëruar zëvendësministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.

Pas mbarimit të ushtrimit të detyrave në pozitat e lartcekura të zëvendësministrit, ankuesi më datë 12.06.2020 i është drejtuar Kryetarit të Komunës së Dragashit me kërkesë për kthim në vendin e punës në pozitën e Bashkëpunëtorit të Lartë Profesional dhe Inspektor i Tatimeve në Komunën e Dragashit. Kryetari i Komunës së Dragashit sipas shkresave të lëndës nuk është përgjigjur në kërkesën e ankuesit, dhe kjo konfirmohet edhe nga ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shëlbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, bazuar në provat e lëndës, ka konstatuar se ankuesi më datë 12.06.2020 ka parashtruar kërkesë me numër protokolli 02-1/2/02-8372 të Kryetari i Komunës së Dragashit, përmes të cilës ka kërkuar kthim në vendin e punës në Komunën e Dragashit, ndërsa kundër heshtjes administrative ankuesi me datë 06.04.2021 ka parashtruar ankesë Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për shëlbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, konstaton se me Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative është përcaktuar afati ligjore për parashtrimin e ankesës kundrejt heshtjes administrative, gjegjësisht neni 127 paragrafi 4 përcakton se: *Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ.* Andaj meqenëse ankuesi ka parashtruar kërkesë



me datë 12.06.2020 në Komunën e Dragashit, ndërsa për shkak të heshtjes administrative i njëjti ka parashtruar ankesë me datë 06.04.2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji konstaton se ankesa e parashtruar me datë 06.04.2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është parashtruar jashtë afatit të përcaktuar me nenin 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe rrjedhimisht në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ankesa e ankuesit është e papranueshme.


Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.251/2021**

**Avdyll BEKTESHI**



**Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional**



**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Dragashit;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Dragashit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

